

Formular për SYLLABUS të Lëndës-Mikrobiologji

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Mikrobiologji
Niveli:	Bsc. Drejtimi Prodhim bimor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I-rë , semestri i parë
Numri i orëve në javë:	2+2 (30/30)
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë,
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Driton Sylejmani, Prof.dr. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Detajet kontaktuese:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë driton.sylejmani@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs studentët do të marrin informacione për: mikrobiologjinë si shkencë, format e mikroorganizmave dhe ndarjen e tyre, klasifikimin e mikroorganizmave dhe rolin e tyre në prodhimin bimor. Pastaj do njihen me ekologjinë e mikroorganizmave, fiziologjinë, metabolizmin, shumimin dhe frymëmarrjen e mikroorganizmave. Poashtu do të jepet informacion për mikroorganizmat si: cianobakteret, bakteret, kërpudhat, virusët, pastaj metanogjenezën dhe metanogjenet. Rolin e mikroorganizmave në qarkullimin e karbonit dhe të azotit. Mikroorganizmat në biogjeosferë. Mikroflora e bimëve dhe rëndësia e saj.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që studentët e këtij niveli të studimeve të mund të marrin njohuri dhe aftësi të përgjithshme dhe speciale për mikroorganizmat. Ky kurs ka për qëllim ofrimin e të gjitha njohurive që kanë të bëjnë me proceset kryesore të mikroorganizmave (fiziologjine, metabolizmin, shumëzimin, të ushqyerit dhe frymëmarrjen e mikroorganizmave) si dhe me disa procese ku marrin pjesë si në qarkullimin e karbonit, azotit etj. Studentët do të njihen edhe me mikroflorën e bimëve dhe rëndësinë e kësaj mikroflоре.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të : <ul style="list-style-type: none">• Kenë njohuritë e duhura për mikrobiologjinë dhe mikroorganizmat e rëndësishëm për kursin në fjalë• Dijnë të klasifikojnë mikroorganizmat

	<ul style="list-style-type: none"> • Njohin format kryesore të mikroorganizmave • Aplikojnë njohuritë e fituara duke identifikuar mikroorganizmat e ndryshëm • Identifikojnë mikroorganizmat që marrin pjesë në fiksimin e azotit • Njohin mikroflorën e bimëve.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)	
Aktiviteti	Orë Ditë/javë Gjithësej
Ligjërata	2 15 30
Ushtrime (pune praktike, seminare, ushtrime,	2 15 30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	1 15 15
Detyra të shtëpisë	
Kolokiume, seminare etj.	1 3 3
Koha e studimit vetanak	2 15 30
Përgatitja përfundimtare për provim	1 15 15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	1 2 2
Totali	
	125
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Mund të ndryshojë dhe bazohet në punën individuale dhe bashkëpunimi në grup. Metodatat e mësimdhënies që do të përdoren janë ligjërat, puna në grupe, seminare, prezantime, demonstrime, vizita studimore.</i></p> <p><i>Ligjërata (40%)</i> <i>Puna praktike (20%)</i> <i>Pune individuale dhe prezantim nga studentet (20%)</i> <i>Udhëzues tjerë (10%)</i> <i>Vlerësimi (10%)</i></p>
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Alternativa të shumëfishta, E saktë/E pasaktë, dhe Ese pyetje.</i></p> <p><i>Vlerësimi i parë: 25%,</i> <i>Vlerësimi i dytë: 25%</i> <i>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</i> <i>Vijimi i rregullt 10%</i> <i>Provimi final 30%</i> <i>Total 100%</i></p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Kapituj të zgjedhur nga burimet e mëposhtme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • M.Gillings & A.Holmes: Plant Microbiology (2004)

	<ul style="list-style-type: none"> Varma, Ajit, Abbott, Lynette, Werner, Dietrich: Plant Surface Microbiology (2007)
Literatura shtesë:	Materialet e ligjëratave dhe ushtrimeve (Skriptat) të përgatitura nga profesori i lëndës.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje. Mikrobiologjia si lëndë.
<i>Java e dytë:</i>	Morfologjia dhe ndërtimi i mikroorganizmave.
<i>Java e tretë:</i>	Ekologjia e mikroorganizmave. Faktorët abiotik dhe biotik
<i>Java e katërt:</i>	Metabolizmi i mikroorganizmave. Frymëmarrja e
<i>Java e pestë:</i>	Rritja, të ushqyerit dhe shumëzimi i mikroorganizmave.
<i>Java e gjashtë:</i>	Metanogjeneza dhe metanogjenet.
<i>Java e shtatë:</i>	Cianobakteret dhe bakteret.
<i>Java e tetë:</i>	Kërpudhat (majatë dhe myqet).
<i>Java e nëntë:</i>	Virusët dhe bakteriofaget.
<i>Java e dhjetë:</i>	Roli i mikroorganizmave në qarkullimin e karbonit në natyrë
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Roli i mikroorganizmave në qarkullimin e azotit në natyrë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Mikroorganizmat në pedosferë.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mikroorganizmat në biosferë.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Mikroflora e bimëve dhe roli i saj.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Mikroflora e rizoferës, epifite, parazite.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> Suksesi i studentit në këtë kurs do të varet nga zhvillimi i vetdisiplinës. Rregullat e mëposhtme do të ndihmojnë në sigurimin e përvojës së të mësuarit për secilin. Arsimtari i lëndës do të fillojë mësimin vetëm nëse klasa është e pastër dhe e rregulluar dhe nëse në klasë do të jenë materialet e nevojshme për fillimin e mësimit. Studentëve nuk u lejohej që të hanë ushqim ose pije në klasë gjatë orës së mësimit. Të gjitha pajisjet elektronike dhe telefonat celularë duhen të fiken gjatë orës së mësimit (përveç nëse kërkohen nga mësuesi). Studentët duhet të ndjekin udhëzimet e mësuesit gjatë gjithë kohës së mësimit dhe të mos flasin pa u dhënë leje. Studentët janë të obliguar që menjëherë dhe rregullisht të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat dhe ushtrimet dhe që nga dita e parë e fillimit të mësimit do të bëhet mbajtja e evidencës mbi vijimin e mësimit. Do të mbahet dokumentacion i shkruar për çdo mashtrim apo pandershmeri gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit.